




DURRËS
ORTOFOTO E PËRFTUAR NGA IMAZHET SATELITORE

Publikimi i Hartës së Ndërtesave në Zonën me Rrezik Përmbytje të Basenit Drin-Bunë

ASIG ka publikuar në platformën ArcGIS Online hartën e ndërtesave të vendosura brenda zonave me rrezik përmbytjeje në Basenin Drin-Bunë. Ky informacion mbështet parandalimin dhe planifikimin strategjik, reagimin e shpejtë, si dhe ndihmon institucionet në hartimin e masave parandaluese për zvogëlimin e rrezikut.



Zgjerimi i Hartës Bazë - Kuçovë



ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën "Harta Bazë", si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale të zonës së Kuçovës. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rievimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rievuar prej 10.8 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rievime fotogrametrike 3D arrin në 180.


Publikime në Gjeoportalin Kombëtar

Informacion Gjeohapësinor për Zonat Arkeologjike


ASIG ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar informacionin gjeohapësinor mbi zonat arkeologjike të Shkodrës, Vlorës dhe fshatit Lin në Pogradec, bazuar në Vendimet e Këshillit të Ministrave për shpalljen e tyre si "Pasuri kulturore të paluajtshme" dhe miratimi i zonifikimit dhe i planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

Për më shumë informacion, klikoni në link-et më poshtë:

- [Zona Arkeologjike Shkodër](#)
- [Zona Arkeologjike Vlorë](#)
- [Zona Arkeologjike Lin, Pogradec](#)



Informacion Gjeohapësinor për Zonat me Rreziqe Natyrore



ASIG në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), si autoritet përgjegjës për temën "Zonat me rreziqe natyrore", ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresën gjeohapësinore "Zjarret (2024)".

Ky informacion përmban të dhëna mbi zonat e prekura nga zjarret në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 2024, të krahasuara me informacionin e raportuar nga Prefekturat në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile.

Për më shumë informacion, klikoni në linkun më poshtë:


[Metadeta dhe detaje mbi shtresën.](#)

Mbulesa e Tokës për 43 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore

ASIG ka publikuar hartën tematike "Mbulesa e Tokës" (Land Cover) për 43 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore, ndërsa procesi vijon për 18 njësi të tjera që janë në fazën e analizimit. Kjo hartë digjitale dhe interaktive pasqyron në mënyrë të detajuar përdorimin dhe karakteristikat e sipërfaqes tokësore në Shqipëri.

Të dhënat janë të disponueshme si Web Map në ArcGIS Online, duke lehtësuar aksesin dhe përdorimin e tyre nga institucionet publike në kohë reale. Mbulesa e Tokës përfshin informacione mbi sipërfaqet me bimësi, sipërfaqet pa bimësi, pyjet, zonat urbane, sipërfaqet ujore dhe serrat bujqësore.

Për më shumë informacion, vizitoni [dashboard-in](#).



Projekti SOFTMOVE:

Workshop mbi "Rolin e Autoriteteve të Transportit dhe Operatorëve në Qytetet Inteligjente"

ASIG organizoi më 27 shkurt 2025 workshop-in me temë "Roli i Autoriteteve të Transportit dhe Operatorëve në Qytetet Inteligjente", në kuadër të projektit SOFTMOVE, bashkëfinancuar nga Programi Interreg IPA South Adriatic 2021-2027.

Ky aktivitet angazhoi ekspertë nga sektori publik dhe privat, akademikë, SME-të dhe startup-et e rajonit të Adriatikut Jugor, të cilët ndanë përvojat dhe risitë teknologjike në fushën e monitorimit të trafikut, planifikimit hapësinor, lëvizshmërisë inteligjente dhe intermodale, si dhe transportit inovativ ajror. Ky event shërbeu si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e ideve dhe promovimin e zgjidhjeve të avancuara për zhvillimin e qyteteve inteligjente.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Sentinel-4: Një Epokë e Re për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit në Evropë

Në verën e vitit 2025, do të lëshohet Sentinel-4, misioni i parë evropian për monitorimin e cilësisë së ajrit nga orbita gjeostacionare. Ky satelit do të ofrojë të dhëna çdo orë mbi ndotësit kryesorë atmosferikë, duke përmirësuar parashikimet e ndotjes dhe mbështetjen për politikën mjedisore. Si pjesë e Shërbimit të Monitorimit të Atmosferës Copernicus (CAMS - Copernicus Atmosphere Monitoring Service), Sentinel-4 do të ndihmojë në gjurmimin e ndotjes dhe mbështetjen e masave për ajër më të pastër në Evropë.

LIST siguron financim nga ESA për projekte të Binjakut Digjital të Tokës

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë së Luksemburgut (LIST - Luxembourg Institute of Science and Technology) ka siguruar financim nga Agjencia Evropiane e Hapësirës (ESA - European Space Agency) për tre projekte në kuadër të nismës së Binjakut Digjital të Tokës. Këto projekte fokusohen në bujqësi, qëndrueshmëri urbane dhe mbrojtje bregdetare, duke integruar Vëzhgimin e Tokës me satelit (EO - Earth Observation) dhe inteligjencën artificiale për të përmirësuar analizat dhe parashikimet mjedisore. LIST po zhvillon harta të avancuara për përmbytjet, sisteme për menaxhimin e sfidave klimatike dhe një platformë inovative për monitorimin bujqësor, duke mbështetur politikëbërësit në hartimin e strategjive efektive për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

AKTIVITETE NË VIJIM

Commercial UAV Expo Europe

Ekspozita Komerciale e UAV-ve të Evropës, aktiviteti kryesor për dronët komerciale, do të zhvillohet nga 8-10 prill 2025 në Amsterdam. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të zbulojnë strategji dhe zgjidhje të zbatueshme, të njohin përparimet më të fundit në teknologjinë ajrore dhe të krijojnë kontakte me profesionistë të industrisë.

8 - 10 Prill 2025

www.asig.gov.al

Geospatial World Forum (GWF)

Forumi Botëror i Gjeoinformacionit (GWF) do të zhvillojë edicionin e 16-të, në Madrid, Spanjë. Ky forum është një platformë bashkëpunuese dhe interaktive që pasqyron vizionin e përbashkët të komunitetit global gjeohapësinor duke mbledhur profesionistë, agjenci kombëtare të hartografisë, sektorin privat, si dhe përdorues të rëndësishëm nga qeveria dhe shërbimet për qytetarët.

22 - 25 Prill 2025

Telefon: +355 (0)42 223 762;

QGIS User Conference 2025

Konferenca vjetore e QGIS do të mbahet më 2-3 qershor 2025 në Norrköping, Suedi, duke ofruar një platformë për ekspertë dhe profesionistë të fushës së gjeoinformacionit. Ky aktivitet ka për qëllim prezantimin e zhvillimeve më të fundit dhe shkëmbimin e njohurive mbi aplikimet inovative të QGIS në analizën dhe menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore.

2 - 3 Qershor 2025

www.geoportal.asig.gov.al

E-mail: info@asig.gov.al

Rruga Papa Gjon Pali II Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë;